

E nderuar znj. Hysi, Zëvendëskryetare e Kuvendit,  
Shkëlqesi Ambasadorë,  
E nderuar znj. Ballanca, Avokate e Popullit,  
Të nderuar Titullarë të Institucioneve të Pavarura,  
Përfaqësues të Institucioneve Qendrore,  
Përfaqësues të përfaqësive diplomatike,  
Përfaqësues të shoqërisë civile,  
Përfaqësues të biznesit,  
Të nderuar pjesmarrës,  
Të dashur miq,

Kam nderin dhe kënaqësinë, në cilësinë e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, t'ju uroj mirëseardhjen dhe t'ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj në këtë takim.

Në vitin 2008 u miratua ligji nr. 9887 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, me anë të të cilit u krijua Institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në vitin 2014, me miratimin e ligjit nr. 119 “Për të drejtën e informimit”, institucionit ju shtua edhe një detyrë tjetër shumë e rëndësishme, duke u emërtuar Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Gjatë kësaj periudhe është arritur që të kemi një legjislacion të plotë dhe të vlerësuar konform standarteve të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian, në të dy fushat kryesore të veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit.

Për mbrojtjen e të dhënave personale është punuar për plotësimin e kuadrit ligjor në të gjitha fushat, ndërgjegjësimin e shtetasve dhe të kontrolluesve, trajtimin e ankesave, marrëdhëniet ndërkombëtare ku Zyra e Komisionerit është anëtare e të gjitha forumeve evropiane e botërore.

Që prej dy vitesh jemi anëtar edhe të forumit të Komisionerëve të vendeve anëtarë të Bashkimit Evropian, gjë që tregon vlerësimin dhe arritjen e objektivit nga zyra e Komisionerit për të qënë pjesë e BE në këtë fushë.

Legjislacioni për të drejtën e informimit sot renditet i gjashti në botë, dhe një standart kaq i lartë detyrimisht kërkon një institucion që t'i përgjigjet. Me modesti konstatojmë se diçka e mirë po bëhet.

Për herë të parë kemi vendime të Komisionerit për çështje që lidhen me transparencën e Autoriteteve Publike, të cilat po ndryshojnë një mënyrë pune të kultivuar thellë, ku çdo akt i tyre nuk mund të ishte publik, në atë, që pikërisht se është një akt i një institucioni publik, duhet të jetë patjetër transparent.

Zyra e Komisionerit ka edhe disa detyra të ngarkuara me akte të tjera ligjore, ku do të veçoja shqyrtimin e ankesave për ligjin nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

Këto të dyja, konsiderohen ligjet që ndriçojnë skutat e errëta të administratës publike dhe zbatimi i tyre ndihmon në mirëqeverisje.

Privatësia dhe transparenca, duken si dy koncepte që kanë një lloj kundërshtie me njëra tjetrën.

Por në fakt, jo. Privatësia është një garanci për jetën private të qytetarit, ashtu si po njësoj garanci për ta, është edhe transparenca e Autoriteteve Publike.

Dhe Zyra e Komisionerit ju siguron që do të vazhdojë në këtë drejtim.